



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARCHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr./Inv./Br./Inv. D1-470/03-18586
Data/Datum/Date 23.12.2024

Gjakovë - Djakovica - Gjakova

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjakovës

PLANI VJETOR 2025

23/12/2024

Njësia e Auditimit të Brendshëm
Mob. +383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53., Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

I. HYRJE

Ky Plan Vjetor është përpiluar në bazë të Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën e viteve 2025 - 2027 të miratuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit. Ai përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të planifikuar të auditimit.

Detyrat e auditimit për vitin 2025 ndikohen dhe ndahen në bazë të burimeve njerëzore që ekzistojnë në NjAB, me ç' rast aktualisht ka mungesë të auditorëve ku funksionin e auditorit e kryen vetëm Udhëheqësi i NjAB-së.

Plani Vjetor mund të rishikohet gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në organizatë apo në NjAB, dhe çdo detyrë shtesë që propozohet nga udhëheqësi i organizatës.

Çdo ndryshim i Planit Vjetor do të aprovet nga Kryetari i Komunës, së Gjakovës.

II. AKTIVITETET E NJAB PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Me planin vjetor parashihen elemente kyçe të kontrollit të brendshëm në mënyrë që menaxhmentit t'ju epet siguri për funksionimin e sistemeve për të cilat janë përgjegjës në mënyrë që menaxhmenti t'i dizajnojë, zbatojë dhe kontrollojë punën që e realizon në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Për arritjen e objektivave të përshkruara në Planin Strategjik për vitin 2025 - 2027, NjAB planifikon që gjatë vitit 2025 të realizojë detyrat dhe aktivitete si në vijim:

Nr.	Objektivi strategjik	Aktivitetet për arritjen e objektivit	Detyrat
1	Përkufizimi i 'universit të auditimit që përfshin të gjitha fushat/aktivitetet e organizatës të cilat i nënshtrohen auditimit të brendshëm	Rishikimi i fushave/aktiviteteve të OB-së, duke ofruar vlerësime objektive dhe rekomandime për përmirësim	DSHS

2	Ofrimi i qasjes objektive të bazuar në rrezik për përkufizimin e punës së AB-së;	Vlerësimi i rreziqeve për strukturat organizative të komunës përmes rishikimit të proceseve dhe vlerësimit të rreziqeve me qëllim të përmirësimit të kontroleve të brendshme.	DSHS
3	Asistimi i NjAB-së në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në organizatë;	Rishikimi, përfundimi dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim. Rishikimi dhe vlerësimi i të kuptuarit të funksionimit të kontrollit të brendshëm nga menaxhmenti.	DSHS
4	Lejimi i NjAB-së që të optimizojë përdorimin e burimeve të saja dhe të përmirësojë efektivitetin e saj si shërbim për menaxhmentin	Angazhimet për plotësimin NjAB-së me staf të mjaftueshëm profesional në bashkëpunim me Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Zhvillim i vazhdueshëm profesional.	DSHS
5	Prezantimi i standardeve dhe treguesve të cilët mund t'u ndihmojnë auditoreve të brendshëm në matjen e avancimit në punën e tyre dhe në arritjen e qëllimeve të veçanta strategjike	Vlerësimi i brendshëm i aktiviteteve të auditimit dhe monitorimi i cilësisë së raporteve nga Udhëheqësi i NjAB-së dhe Komiteti i Auditimit	DSHS
6	Demonstrimi tek menaxhmenti se aktivitetet e auditimit të brendshëm realizohen në mënyrë kompetente	Raportimet, komunikimet e raporteve të auditimit tek menaxhmenti i lartë, Komiteti i Auditimit, Njësia e audituar, dhe NJQHAB-së	DSHS

Tabela 1. Objektivat Strategjike

III. DETYRAT E AUDITIMIT

3.1. Detyrat e pa zbatuara nga viti i kaluar

Detyrat e auditimit të planifikuara për vitin 2024 janë realizuar sipas planit vjetor 2024 dhe plotësim/ndryshimit të planit vjetor 2024, të cilat kanë qenë në përputhje me Planin Strategjik 2024 – 2026.

3.2. Detyrat e auditimit të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2025

Njësitë e synuara dhe detyrat e mëposhtme janë përfshirë në planin e tanishëm varësisht nga rreziku i përcaktuar si më poshtë:

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob.+383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net
Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53, Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

Nr.	Njësiti e synuara të auditimit	Treguesi i rrezikut	Prioritizimi	Numri i detyrave për 2025	Nr. i ditëve të punës për person sipas strategjisë
1	Njësia e Prokurimit	L	3	1	30
2	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	L	3	2	30
4	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	L	3		
5	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	L	3		
6	Drejtoria për Infrastrukturë	L	3	3	30
7	Sektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve	L	3		
8	Drejtoria për Shërbime Publike	L	3		
9	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	L	3	4	30

Tabela 2. Njësiti e synuara të auditimit për vitin 2025

Totali për detyrat në pajtim me vlerësimin e rrezikut dhe strategjinë e auditimit	Auditori	Udhëheqësi i NjAB-së
Implementimi i detyrave të auditimit nga NjAB	-	120
Trajnim dhe Kualifikim	-	30
Aktivitetet Administrative	-	15
Planifikimi strategjik dhe vjetor	-	10
Monitorimi periodik	-	10
Auditim i mëhershëm	-	8
Shërbime Këshilluese	-	10
Përcjellja e Rekomandimeve	-	10
Numri i përgjithshëm i ditëve për aktivitete të auditimit të brendshëm	-	213

Tabela 3. Planifikimi i ditëve sipas aktiviteteve të auditimit të brendshëm - 2025

3.3. Llojet e detyrave të auditimit

Pas analizës së bërë të sistemeve nga NjAB dhe duke u bazuar në kapacitetet aktuale të NjAB-së, janë përzgjedhur detyrat me rrezikshmëri të lartë si fokus i auditimit për vitin 2025. Si dhe se me qëllim të mbulimit të më shumë njësive komunale, është bërë bashkimi i njësive në bazë të objektivit të detyrës të paraqitur si në vijmë:

Njësia	Objektivi i detyrës	Fushëveprimi i detyrës	Indeksi	Lloji	Perioda 2025
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Të sigurohemi se realizimi i të hyrave vetanake është sipas planifikimit dhe barazimi i të hyrave bëhet me thesarin sipas afateve të përcaktuara kohore. procedurat janë duke u zbatuar në mënyrë transparente dhe të sakta sipas legjislacionit në fuqi	Rishikimi i aktiviteteve për vitin 2024	2.70	DSHS 2501	Shkurt - Prill
+Drejtoria për Infrastrukturë + Drejtoria për Shërbime Publike +Sektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillim të Projekteve	Te sigurohemi se njësitë e synuara të auditimit bëjnë menaxhimin e projekteve në përputhje me kërkesat ligjore, doracakun për menaxhimin e kontratave, procedurave standarde të operimit dhe praktikave të mira për menaxhimin e projekteve.	Rishikimi i aktiviteteve për periudhën 2024 deri më datën e fillimit të auditimit	2.70	DSHS 2502	Prill - Qershor
Njësia e Prokurimit	Të sigurohemi se njësia e prokurimit ka planifikuar, zhvilluar procedurat e prokurimit, ka vlerësuar tenderët, dhe ka kontraktuar me kohë dhe në pajtim me ligjet në fuqi;	Rishikimi i aktiviteteve për periudhën 2024 deri më datën e fillimit të auditimit	2.70	DSHS 2503	Gusht - Tetor
+Drejtoria për Zhvillim Ekonomik +Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural +Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Ky auditim do të jetë i performancës me objektiven e vlerësimit të efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit të planifikimit, ndarjes dhe monitorimit të subvencioneve në DZHE, DBPZHR, DKRS	Rishikimi i aktiviteteve për periudhën 2023, 2024 dhe 2025 (deri më datën e fillimit të auditimit)	2.70	DSHS 2504	Tetor - Dhjetor

Tabela 4. Llojet e detyrave të auditimit 2025

Detyra e auditimit të planifikuar për vitin 2025 përputhet me strategjinë e aprovuar të auditimit. Raporti në mes të detyrave të planifikuar në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor tregohet në tabelë dhe është si vijon:

Llojet e detyrave të auditimit	Numri i detyrave	Numri i përgjithshëm	Detyrat e auditimit sipas	Zbatimi i planit i
--------------------------------	------------------	----------------------	---------------------------	--------------------

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Mob.+383 (0) 44 59 69 79; e-mail: arber.gola@rks-gov.net

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 53, Ish. Ndërtesa e Bankosit, Gjakovë

	për vit	m i ditëve për person	Planit Strategjik	shprehur në përqindje
Detyrat për shërbimet e sigurisë	4	120	4	100%
Rrezik i lartë	4	120	4	100%
Rrezik i mesëm	/	/	/	/
Rrezik i ulët	/	/	/	/

Tabela 5. Detyrat për shërbimet e sigurisë

V. PROKURIMI I BURIMEVE DHE NDARJA E DETYRAVE TË AUDITIMIT

5.1. Koha efektive e punës

Koha efektive e punës e kalkuluar, për NjAB, është, në pajtueshmëri me strategjinë e auditimit dhe është e llogaritur vetëm për Udhëheqësin e NjAB-së, si vijon:

Auditorët	Totali i ditëve të punës	Pushimi vjetor	Pushimi mjekësor	Koha efektive e punës	Trajnim dhe kualifikim	Aktivitetet Administrative	Planifikim strategjik dhe	Monitorim periodik	Auditimet e mëhershme	Shërbime Këshilluese	Përcjellja e Rekomandimeve	Implementimi i detyrave të auditimit
1	2	3	4	5= 2 - 3 - 4	6	7	8	9	10	11	12	13=5 - (6+7+8+9+10+11+12)
Udhëheqësi i NjAB	248 ¹	25	10	213	30	15	10	10	8	10	10	120

Tabela 6. Koha efektive e punës

Për të përmbushur objektivat e këtij Plani Vjetor 2025 angazhimi i stafit të NjAB - së do të jetë maksimal. Faktorët të cilët mund të ndikojnë mos arritjen e planit janë rastet të jashtëzakonshme shëndetësore të stafit, trajnimet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, kërkesa të bazuara për auditim AD HOC të kërkuar nga Kryetari i Komunës, apo ndonjë aktivitet i paparashikueshëm i NjAB-së.

Kryetari i Komunës

z. Ardian Gjini

Kryesuesi i KA-së

z. Florent Koci

Udhëheqësi i NjAB-së

z. Arbën Gola

23/12/2024

¹ Totali i ditëve të punës është llogaritur si në vijim: Totali i ditëve vjetore: 365 – 13 (festat zyrtare) – 104 (fundjava) = 248 ditë pune